



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201402562/7

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

**Lënda:** *Rekomandohet revokimi i pikës pesë të letër porosisë nr.8701 Prot., datë 03.09.2014 të DPBurgjeve*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**  
Z. Artur ZOTO

**TIRANË**

*I nderuar z. Zoto,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i dënuari B. E., i cili pretendon se kërkesa e tij për të përfituar leje shpërblyese është refuzuar pa të drejtë megjithëse ai i plotëson kushtet ligjore.

Për verifikimin e kësaj ankese nga ana jonë është administruar dokumentacioni i praktikës së ndjekur për këtë rast. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, kërkesa e të dënuarit B. E. për të përfituar leje shpërblyese është refuzuar pasi, në pikën pesë të letër porosisë nr.8701 Prot., datë 03.09.2014 të DPBurgjeve, IEVP-të porositen të mos miratojnë leje shpërblyese për personat që kanë kryer vepra penale që përbëjnë rrezik përsëritje si psh. Kapitulli "krime seksuale" i Kodit Penal, nenet 100 dhe 101. Bujar Elmazi është dënuar për veprën penale "marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur". Kjo letër porosi ka dalë në bazë të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe Udhëzimit nr. 103, dt. 14.02.2014 të Ministrit të Drejtësisë.

Nga analiza e legjislacionit të lartpërmendur nuk rezulton që, kryerja e veprave penale të parashikuara në nenet 100 dhe 101 të Kodit Penal të jetë përcaktuar si kriter ndalues për dhënien e lejes shpërblyese. Në nenin 59 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 parashikohen disa kushte që duhet të plotësohen nga i dënuar që kërkon të përfitojë leje shpërblyese. Një nga këto kushte që vlerësohen nga IEVP-ja është nëse i dënuari paraqet ose jo rrezikshëmëri shoqërore. Për të bërë një vlerësim sa më objektiv të këtij kushti, nuk merret në konsideratë vetëm natyra e veprës penale që ka kryer i dënuari por, edhe sjellja e tij në institucion, pjesëmarrja në programet rehabilituese dhe informacioni i policisë së shtetit. Një nga qëllimet e dënimit me burg është riintegrimi i të dënuarit në shoqëri nëpërmjet programve rehabilituese, përfshirë

edhe të dënuarit që kanë kryer veprat penale të parashikuar në nenet 100 dhe 101 të Kodit Penal. Dërgimi i të dënuarit me leje shpërblyese i shërben këtij qëllimi. Për këtë arsye, vlerësimi i rrezikshmërisë që paraqet i dënuari që kërkon të shkojë me leje shpërblyese duhet të bëhet rast pas rasti dhe nuk mund të refuzohet kërkesa vetëm duke ju referuar natyrës së veprës penale.

Referuar nenit 118 të Kushtetutës, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Pika pestë e letër porosisë nr.8701 Prot., datë 03.09.2014 të DPBurgjeve ka tejkalar përcaktimet e ligjit duke shtuar si kriter ndalues për të përfituar leje shpërblyese veprat penale të parashikuara në nenet 100 dhe 101 të Kodit Penal.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*"

### **J U R E K O M A N D O J M Ë:**

Revokimin e pikës pikës pesë të letër porosisë nr.8701 Prot., datë 03.09.2014 të DPBurgjeve.

Në bazë të nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

**Në Mungesë  
dhe me Porosi**

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**